

Proçesi i Privatizimit

2014-02-27 10:34:00

BAZA LIGJORE PËR PRIVATIZIM

Një nga objektivat e rëndësishme të qeverisë në fushën e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik të vendit është edhe përshtetimi i procesit të privatizimit të pronës shtetërore të regjistruar në emër të shtetit Shqiptar. MZHETS ka përgatitur paketën e parë të privatizimit të aseteve shtetërore, informacion që në mënyrë transparente i bëhet prezent çdo të interesuari që do të kërkojë të dhëna me interes dhe në përmbushje të plotësimit e ndjekjes së të drejtave të tij që lidhen me pronësisë.

Lista e paketës së parë të privatizimeve të aseteve dërguar për shitje në Min.Financave [Klikoni ketu](#)

Lista e paketës së dytë të privatizimeve të aseteve dërguar për shitje në Min.Financave

[Klikoni ketu](#) Lista e paketës së tretë të privatizimeve të aseteve [Klikoni ketu](#)

Lista e paketës së katërt të privatizimeve për vitin 2017 [Klikoni ketu](#)

Për më shumë informacion për çdo aset [Klikoni ketu](#)

Procedurat për privatizimin e aseteve

Cilat janë procedurat për privatizimin e një asemi shtetëror !

- Njëpërmjet kërkesës drejtuar Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes (MZHETS)
- Listave të publikuara nga MZHETS

Kërkesa për privatizimin e një asemi shtetëror mund të drejtohet në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes apo në institucionin përkatës që ka në administrim/ pronësi objektin që kërkon të privatizohet, e cila mund të bëhet nga pronari i truallit ose çdo person tjetër/institucion i interesuar për blerjen e asemi.

1. Çfarë duhet të përmbaje kërkesa:

- Emërtimin e saktë të Institucionit që i drejtohet kërkesa.
- Emërtimin e saktë të objektit dhe vendndodhjen e objektit që kërkon të privatizojë.
- Të dhëna të tjera në lidhje me këtë objekt (nëse ka, p.sh. varësinë administrative të tij, funksionin që ka pasur, gjendjen aktuale të objektit, etj.)
- Identitetin dhe adresën e saktë të personit që drejton kërkesën.
- Çdo dokument apo të dhënë tjetër të vlerësuar nga kërkuesi bashkëngjitur kërkesës.

Nëse kërkuesi është pronar trualli, kërkesa e mësipërme duhet të shoqërohet edhe me:

- vendimin përkatës të komisionit të kthimit dhe kompensimit të pronave, njëpërmjet të cilit personi apo trashëgimtarët kanë të drejtën e parablerjes së objektit përkatës, së bashku me plan vendosjen e tij.

Nëse kërkesa bëhet në Institucionin administrues të asemi:

Ky i fundit, sipas vendim marrjes së tij dërgon në MZHETS prononcimin pozitiv për privatizimin e asemi, së bashku me kërkesën përkatëse/ ose i përgjigjet të interesuarit në lidhje me arsyet e mosmiratimit për privatizim të objektit përkatës.

2. Si kryhet përfshirja në procesin e privatizimit të një asemi:

Nëse kërkesa për privatizim bëhet pranë Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik Tregtisë dhe Sipërmarrjes:

1. MZHETS pas shqyrtimit të kërkesës së bërë nga i interesuari, i kërkon strukturës administrative të objektit prononcimin për privatizimin e tij

- Nëse institucioni administrues përgjigjet pozitivisht për privatizimin e objektit të kërkuar, atëherë Ministri i MZHETS miraton privatizimin e objektit dhe urdhëron fillimin e procedurës për vlerësimin e objektit me qëllim privatizimin.
- Nëse Institucioni administrues përgjigjet negativisht për privatizimin e objektit të kërkuar, atëherë MZHETS njofton kërkuuesin për mos përfshirjen në privatizim të objektit të kërkuar, duke i bërë të ditur përgjigjen e institucionit administrues.

2. Pas fillimit të procedurës për vlerësimin e objektit, vazhdon përgatitja e dokumentacionit të privatizimit (dosja e privatizimit), në Degën e Shoqërisë Publike të qarkut përkatës.

3. Pas përfundimit të dosjes së Privatizimit, ajo dërgohet pranë Ministrisë së Financave, në Drejtorinë Drejtimit të Pronave, e cila realizon procedurat e shitjes në zbatim legjislativ në fuqi.

[Skema e ndjekjes së procedurave të privatizimit](#)

Më poshtë gjeni bazën ligjore të detajuar.

[Baza ligjore për shoqëritë në likuidim](#)

[Baza ligjore e shoqërive jo strategjike](#)

[Baza ligjore e shoqërive strategjike](#)